

NDJESA E PLOTË ÇFARË ËSHTË, KU, SI KUR...



ARQIPESHK VIA METROPOLITANE E SHKODËR-PULTIT

Të gjithë besimtarët me të vërtetë të penduar: duke përjashtuar çdo lidhje me mëkatit, të nxitur nga një shpirt bamirësie dhe që, gjatë Vitit të Shenjtë, të pastruar nëpërmjet sakramentit të pendimit dhe të ushqyer nga Kungimi i Shenjtë, do të luten sipas synimeve të Papës, prej thesarit të Kishës do të marrin ndjesën e plotë, faljen dhe ndjesën e mëkateve të tyre, të cilat mund të përdoren për shpirtrat e Purgatorit në formën e lutjes për ta.



KU

1. Në shtegtimet e shenjta

- drejt çdo vendi të shenjtë jubilar:
- në Romë, në Tokën e Shenjtë dhe, në Dioqezën tonë, në kishën katedrale.

SI

- * Duke marrë pjesë devotshmërisht:
- * në Meshën e Shenjtë;
- * në kremtimin e Fjalës së Hyjit;
- * në Liturgjinë e Orëve;
- * në himnin Akathistos;
- * në një kremtim pendestar.

KU

2. Në vizitat e devotshme në çfarëdo vendi jubilar:

- në Romë dhe, në Dioqezën tonë, në Bazilikën minore Shenjtërore “Zoja e Këshillit të Mirë”.

SI

- * adhurim eukaristik dhe meditim;
- * duke përfunduar, me lutjen Ati ynë, Dëshminë e Fesë në çfarëdo forme legjitime dhe lutje drejtuar Marisë, Nënës së Hyjit.

KUSH

Besimtarët me të vërtetë të penduar, që nuk mund të marrin pjesë në kremtimet solemne, në shtegtimet dhe në vizitat e përshpirtshme për shkaqe të rënda do ta marrin ndjesën e plotë, me po këto kushte nëse, të bashkuar në shpirt me besimtarët e pranishëm, veçanërisht në momentet kur fjalët e Papës së Shenjtë dhe të Ipeshkvijve dioqezanë do të transmetohen nëpërmjet mjeteve të komunikimit, duke ofruar vuajtjet apo vështirësitë e tyre të jetës.

KU

3. Në veprat e mëshirës dhe të pendesës:

- duke marrë pjesë në Misionet popullore;
- duke marrë pjesë në ushtrimet shpirtërore;
- duke marrë pjesë në takime formimi mbi tekste të Koncilit II të Vatikanit dhe të Katekizmit të Kishës.

SI

- * Nëpërmjet veprave të mëshirshme trupore dhe shpirtërore;
- * duke vizituar për një kohë të përshtatshme vëllezërit në nevojë ose vështirësi (të sëmurë, të burgosur, të moshuar të vetmuar, persona me aftësi të kufizuara...);
- * duke respektuar kushtet e zakonshme shpirtërore, sakramentale dhe të lutjes;
- * duke rizbuluar në veçanti vlerën pendestare të së Premtes:
 - duke iu larguar shpërqendrimeve të kota (reale, por edhe virtuale, për shembull nga media) për të paktën një ditë;
 - duke iu larguar konsumimit të tepërt (për shembull duke agjëruar ose duke praktikuar abstinencën sipas normave, si dhe duke dhuruar një shumë të përpjesëtuar parash të varfërve);
 - duke mbështetur vepra me karakter fetar ose shoqëror, veçanërisht për mbrojtjen dhe përkrahjen e jetës, të fëmijëve të braktisur, të të rinjve në vështirësi, të të moshuarve nevojtarë apo të vetmuar, të emigrantëve etj.

KUR

Pavarësisht normës sipas të cilës mund të merret vetëm një ndjesë e plotë në ditë, besimtarët që kanë thënë lutjet përkatëse për shpirtrat e Purgatorit (Ati ynë, Të falemi Mari..., Lavdi Atit..., Engjëlli i Zotit), nëse do t'i afrohen në mënyrë legjitime sakramentit të Kungimit për herë të dytë në të njëjtën ditë, mund ta marrin ndjesën e plotë dy herë në të njëjtën ditë, këtë herë vetëm për të vdekurit dhe vetëm brenda kremtimit eukaristik.